

KRU. "GJAKOVA" SHA. Gjakovë			
Marre në datën: 06.07.2020			
Njësia org.	Numri	Shtojca	Vlera
	1149		

K.R.U. GJAKOVA SH.A.

Pasqyrat financiare

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2019

dhe

Raporti i auditorit të pavarur



Deklaratë e pajtueshmërisë

Për pasqyrat financiare që përfundojnë me 31 dhjetor 2019

Deklaroj që pasqyrat financiare për vitin raportues 2019 paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve, dhe rrjedhave të parasë dhe që pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me të gjitha kërkesat e Ligjit 06/L- 032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.


Ismet Ahmeti,
Kryeshef Ekzekutiv


Kastriot Zhaveli,
Zyrtar Kryesor Financiar
dhe i Thesarit

Prishtinë, Kosovë
17 qershor 2020

Përmbajtja

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR	4
RAPORT MBI KËRKESAT E TJERA LIGJORE DHE RREGULLATIVE	7
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	8
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	9
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	10
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	11
1. Informata të përgjithshme	12
2. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare.....	12
3. Përkthimi i valutave të huaja.....	12
4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël	13
5. Vlerësimet kritike të kontabilitetit dhe gjykimet në zbatimin e politikave të kontabilitetit	18
6. Adoptimi i Standardeve të Reja ose të Rishikuara dhe Interpretimeve	19
7. Standardet e reja, interpretimet dhe ndryshimet që nuk janë ende efektive	20
8. Prona, pajisjet dhe impiantet	21
9. Llogaritë e arkëtueshme	21
10. Stoket.....	21
11. Paraja dhe ekuivalentët e saj	22
12. Kapitali Aksionar	22
13. Llogaritë e Pagueshme.....	22
14. Detyrime ndaj punëtorëve dhe tatime.....	22
15. Të hyrat e shtyra.....	22
16. Të hyrat.....	23
17. Shpenzimet e personelit	23
18. Shpenzimet operative dhe administrative.....	23
19. Transaksionet me palët e lidhura	24
20. Menaxhimi i rrezikut financiar	25
21. Detyrimet kontingjente dhe zotimet	26
22. Ngjarjet pas datës së raportimit.....	26

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për aksionarët dhe menaxhmentin e K.R.U. GJAKOVA Sh.A., Prishtinë, Kosovë

Opinion me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të K.R.U. GJAKOVA Sh.A., ('Kompania') të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2019 dhe pasqyra e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë politikat domethënëse të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, përveç për qështjet e shpalosura në paragrafin *Baza për Opinion me Rezervë*, pasqyrat financiare paraqesin drejtë në të gjitha aspektet materiale pozitën financiare të Kompanisë me 31 dhjetor 2019 dhe të performancës financiare dhe rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion me Rezervë

- Siç është shpalosur në shënimin 4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël, Prona, Impiantet dhe Pajisjet deri me 01 janar 2008 barten sipas kostos së vlerësuar minus çdo amortizim dhe humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Pas datës 01 janar 2008 Prona, Impiantet dhe Pajisjet janë vlerësuar sipas modelit të rivlerësimit që është vlera e drejtë e zërave në datën e rivlerësimit minus ndonjë zhvlerësim të mëpasshëm të akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga dëmtimi. Në përputhje me kërkesat e Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16 Prona, Impiantet dhe Pajisjet ("SNK 16"), rivlerësimet do të bëhen në mënyrë të rregullt mjaftueshëm që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e aktivit nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë në datën e raportimit. Rivlerësimi i fundit i Pronës, Impianteve dhe Pajisjeve të kompanisë është kryer me 31 dhjetor 2007 nga një kompani vlerësuese e licencuar.
Siç është paraqitur në shënimin 8 të pasqyrave financiare Prona, Impiantet dhe Pajisjet bartin vlerën neto 38,562,572 Euro me 31 dhjetor 2019 (33,468,298 Euro me 31 dhjetor 2018). Ne nuk ishim në gjendje përmes procedurave alternative të auditimit të vlerësojmë se vlera bartëse e Pronës, Impianteve dhe Pajisjeve është prezentuar në përputhje me kërkesat e SNK 16. Gjithashtu për shkak çështjeve të lartëcekura ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë nëse rezerva e rivlerësimit e paraqitur në pasqyrat financiare është të përshtatshme për të pasqyruar vlerën e totalit të Pronës, Impianteve dhe Pajisjeve në krahasim me vlerën e rikuperueshme të saj.
- Siç është shpjeguar në shënimin 9, Llogaritë e arkëtueshme tregtare prej 7,298,637 Euro me 31 dhjetor 2019 (7,256,626 Euro me 31 dhjetor 2018) paraqesin obligimet e klientëve kryesor të kompanisë. Kompania nuk ka njohur lejime për borxhe të këqija duke marrë parasysh se ka borxhe më të vjetra se pesë vite, për të cilat kompania ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore. Ne përmes procedurave alternative të auditimit nuk kemi arritur të vlerësojmë shumën e saktë të llogarive që duhet të shlyhen ose provizionohen dhe efektin e tyre në pasqyrat financiare. Prandaj gjendja e llogarive të arkëtueshme me 31 dhjetor 2019 është e mbivlerësuar për shumën e borxheve të pashlyera.
Referuar në Standardin ndërkombëtar të raportimit financiar 9 Instrumentet Financiare ("SNRF 9") kërkohet nga ndërmarrja të njohë një provizion për humbje për përkeqësimin e pritshëm të kredisë të një aktivi financiar për të cilat duhet plotësohen kushtet e dëmtimit. Ndërmarrja duhet të zbatojë kërkesat e dëmtimit për njohjen dhe matjen e shumës së humbjes për aktivet

financiare që maten me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse. Sipas SNRF 9 kërkohet që në çdo datë raportimi, një njësi ekonomike të masë provizionin për humbjen e një instrumenti financiar në atë shumë të barabartë me humbjen e pritshme të kredisë përgjatë gjithë jetës së tij nëse rreziku i kreditit të atij instrumenti financiar është shtuar ndjeshëm që nga njohja e tij fillestare.

Siç është shpalosur në shënimin 9 Llogaritë e arkëtueshme tregtare me 31 dhjetor 2019 ka vlerën neto 7,298,637 Euro (me 31 dhjetor 2018 ka vlerën neto 7,256,626 Euro). Kompania ka paraqitur provizion në vlerë prej 7,910 Euro, gjatë vitit 2019 nuk është njohur ndonjë lejim dhe provizion i përgjithshëm i cili do të reflektonte në pasqyrat financiare. Mos ndarja e lejimeve të përgjithshme dhe mos provizionimi i llogarive të arkëtueshme sipas kërkesave përkatëse, mbivlerëson saldona e llogarive të arkëtueshmeve dhe nënvlerëson lejimet në pasqyrën e të ardhurave. Ne përmes procedurave alternative të auditimit nuk ishim në gjendje të përcaktojmë nëse kompania ka zbatuar politikat e provizionimit konform kërkesave të SNRF 9.

Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare* e këtij raporti.

Ne jemi të pavarur nga kompania në pajtueshmëri me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionist të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës (Kodi i IESBA) së bashku me kërkesat që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona tjera etike në pajtueshmëri me këto kërkesa dhe Kodin e IESBA.

Ne besojmë se evidanca e përfutur e auditimit është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazë për opinion.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF dhe për kontrollë të tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Kompanisë të vijoje sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë ose të ndërpresë aktivitetet e kompanisë, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veproje në këtë mënyrë. Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojme evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, tënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontrolleve.
- Përftojme njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.

- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e menaxhmentit dhe bazuar nga evidenca e përftuar e auditimit, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e kompanisë për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përfthuara deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që kompania të mos vijoje aktivitetet e saj.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrës financiare, përfshirë shpalosje nëse pasqyra financiare përfaqëson transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrijë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënës të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënës në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

RAPORT MBI KËRKESAT E TJERA LIGJORE DHE RREGULLATIVE

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të K.R.U. GJAKOVA SH.A. si dhe informacionin e shkruar në raportin e menaxhmentit bazuar në kërkesat ligjore të përcaktuara në *Ligjin Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 10.*

Sipas opinionit tonë raporti i menaxhmentit është në përputhje me pasqyrat financiare për vitin financiar raportues si dhe është përgatitur në përputhje me kërkesat e *Ligjit Nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, neni 10*, dhe *UA Nr.02/2019 për pavarësinë e auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit.*

Raport mbi kërkesat tjera

- Ne jemi angazhuar si auditor të kompanisë K.R.U. GJAKOVA Sh.A. për periudhën 01 janar 2019 – 31 dhjetor 2019, më datë 08 janar 2020 përmes Prokurimit Publik.
- Si pjesë e auditimit në kemi identifikuar dhe vlerësuar rreziqet më të rëndësishme të të anomalive materiale, duke përfshirë rreziqet e vlerësuar të anomalive materiale për shkak të mashtrimit. Më poshtë janë paraqitur rreziqet e rëndësishme dhe përgjigja e auditorit ndaj këtyre rreziqeve.

Njohja e të hyrave

Kompania njeh të hyrat nga shitja duke u bazur në çmimet e aprovuara për metër kub nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit i Kosovës dhe duke zbatuar parimet kontabël nga SNRF 15 siç është paraqitur në shënimin 9 dhe 16 të pasqyrave financiare. Rreziku i njohjes së të hyrave është në kontrollet e brendshme lidhur me procesin e faturimit dhe ndjekjes së pagesave individuale nga konsumatorët shtëpiak.

Përgjigja e auditorit

- o Vlerësimi i politikave të njohjes së të hyrave sipas SNRF 15
- o Vlerësimi i efektivitetit të kontroleve të brendshme të përdorura në njohjen e të hyrave
- o Inspektimi i marrëveshjeve relevante dhe dokumenteve mbështetëse
- Ne kemi dizajnuar procedurat e auditimit në mënyrë që t'iu përgjigjemi rreziqeve të identifikuar për të siguruar dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshmet dhe për të fituar siguri të arsyeshme lidhur me prezantimin e pasqyrave financiare dhe shënimeve shpjeguese.
- Ne konfirmojmë që opinionin e auditimit është në përputhje me raportin shtesë për komitetin e auditimit.
- Ne deklarojmë që nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo audituese të përmendura në *UA nr.02/2019 për pavarësinë e auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit, Neni 5* dhe ne jemi të pavarur ndaj subjektit të audituar gjatë kryerjes së auditimit;

Lulzim Zeka
Auditor ligjor

Baker Tilly Kosovo
17 qershor 2020





bakertilly
Baker Tilly Kosovo L.L.C.
Prishtinë

K.R.U. GJAKOVA SH.A.
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
 Me 31 dhjetor 2019
 Të gjitha shumat në Euro

	Shënime	Me 31 dhjetor 2019	Me 31 dhjetor 2018
PASURIA			
Pasuria Jo-qarkulluese			
Toka, Ndërtesa, Automjetet dhe Paisjet	8	31,479,052	32,519,454
Investimet në vijim	8	7,083,520	948,844
Total pasuria jo qarkulluse (I)		38,562,572	33,468,298
Pasuria qarkulluese			
Të arkëtushmet tregtare	9	7,510,239	7,573,121
Stoqet	10	664,316	604,966
Paraja dhe ekuivalentët e saj	11	457,076	293,609
Total pasuria qarkulluese (II)		8,631,631	8,471,696
Total Pasuria (I+II)		47,194,203	41,939,994
KAPITALI DHE DETYRIMET			
Kapitali			
Kapitali Aksionar	12	25,000	25,000
Rezerva e Rivlerësimit		31,573,655	31,573,655
Fitimi (humbja) e mbajtur		(32,244)	18,505
Total kapitali (III)		31,566,411	31,617,159
Detyrimet afatshkurta			
Llogaritë e Pagueshme	13	1,543,661	2,478,931
Detyrime ndaj punëtorëve dhe tatime	14	90,227	70,835
Të hyrat e shtyra	15	13,993,904	7,773,069
Total detyrimet afatshkurta (V)		15,627,792	10,322,835
Total Detyrimet dhe Kapitali (III+IV+V)		47,194,203	41,939,994

Pasqyrat financiare janë autorizuar, aprovuar dhe nënshkruar në emër të menaxhmentit më 10 Prill 2020:


Ismet Ahmeti,
 Kryeshef Ekzekutiv


Kastriot Zhaveli,
 Zyrtar Kryesor Financiar


Xhevat Rexhepi,
 Kontabiliste e Çertifikuar

Shënimet e bashkangjitura në faqet 9 deri 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

K.R.U. GJAKOVA SH.A.
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2019
Të gjitha shumat në Euro

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor		2,019	2,018
	Shënime		
I. Të hyrat			
Të hyrat	16	5,238,637	4,722,298
Gjithsej të hyrat (I)		5,238,637	4,722,298
II. Shpenzimet			
Shpenzimet e personelit	17	(2,376,161)	(2,122,387)
Shpenzimet operative dhe administrative	18	(1,174,750)	(1,047,927)
Shpenzimet e Zhvlerësimit	8	(1,575,123)	(1,411,491)
Gjithsej shpenzimet (II)		(5,126,035)	(4,581,806)
Fitimi (humbja) nga aktivitetet operative (I + II)		112,602	140,493
III. Fitimi (humbja) financiare			
Shpenzimet Financiare		-	-
Gjithsej fitimi (humbja) financiare (III)		-	-
Fitimi (humbja) para tatimit (I + II + III)		112,602	140,493
Tatimi në fitim		-	-
Fitimi (humbja) neto e vitit		112,602	140,493

Shënimet e bashkangjitura në faqet 9 deri 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

K.R.U. GJAKOVA SH.A.
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2019
Të gjitha shumat Euro

	Kapitali investus	Fitimi (humbja) e mbajtur	Rezerva të Rivleresimit	Gjithsej
Gjendja me 31 Dhjetor 2017	25,000	(121,988)	31,573,655	31,476,667
Rregullimet në fitimin e mbajtur	-	-	-	-
Fitimi (humbja) e vitit	-	140,493	-	140,493
Gjendja me 31 Dhjetor 2018	25,000	18,505	31,573,655	31,617,159
Rregullimet në fitimin e mbajtur	-	(163,351)	-	(163,351)
Fitimi (humbja) e vitit	-	112,602	-	112,602
Gjendja me 31 Dhjetor 2019	25,000	(32,244)	31,573,655	31,566,411

Shënimet e bashkangjitura në faqet 9 deri 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

K.R.U. GJAKOVA SH.A.
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2019
Të gjitha shumat Euro

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor

I. Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative

	2019	2018
Fitimi (humbja) e vitit	112,602	140,493
Të korrigjuara për:		
Zhvlerësimi	1,575,123	1,406,819
Shpenzimet e interesit	-	-
(Rritja)/zvogëlimi në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe tjera	62,882	(314,524)
Rritja/(zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe tjera	(935,270)	735,405
Rritja/(zvogëlimi) në detyrimet ndaj punëtorëve dhe tatimeve	19,392	19,228
Rritja/(zvogëlimi) në të hyrat e shtyra	6,220,835	-
(Rritja)/zvogëlimi në stoqe	(59,350)	(69,491)
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative	6,996,214	1,917,929

Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative (I)

6,996,214	1,917,929
------------------	------------------

II. Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese

Blerjet e pronës, impianteve dhe pajisjeve	(6,667,126)	(3,485,760)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese (II)	(6,667,126)	(3,485,760)

III. Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese

Huamarrjet	(165,621)	(135,424)
Arkëtimet nga donacione	-	1,407,837
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese (III)	(165,621)	1,272,413

IV. Rritja neto në para dhe ekuivalente (I + II + III)

163,467	(295,418)
----------------	------------------

V. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit/periudhës

293,609	589,027
----------------	----------------

VI. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit/periudhës (IV + V)

457,076	293,609
----------------	----------------

Shënimet e bashkangjitura në faqet 9 deri 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informata të përgjithshme

Kompania Rajonale e Ujësjes GJAKOVA SH.A. Gjakovë, më tutje "Kompania" është shoqëri aksionare e inkuorporuar me 29 Maj 2007 në Kosovë, sipas Projektit për Korporatizimin e Sektorit të Ujit në Kosovë.

Kompania është themeluar në pajtim me ligjin mbi shoqëritë tregtare 02/L-123 me numër regjistrimi 70433554 dhe me numër fiskal 600282636, numri unik identu.

Adresa: rr. U.Ç.K. nr.7 – Gjakovë, Kosovë

Lloji i biznesit: Shoqëri aksionare (SHA).

Kapitali themelues: 25,000 €

Kompania me 31 dhjetor 2019 ka pasur 293 punëtorë.

Aktivitetet e Kompanisë janë

Kodi sipas ARISK	Përshkrimi	Tipi
3600	Grumbullimin, trajtimin dhe furnizimin me ujë	Primarë
4313	Testi i shpuarjes dhe shpuarja	Sekondarë
7120	Testimi teknik dhe analizat	Tjera
4675	Tregtia me shumicë e produkteve kimike	Tjera
3700	Kanalizimi	Tjera
9609	Aktivitetet e tjera p.k.t.	Tjera

2. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) sipas konventës së kostos historike.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve kontabël të caktuara kritike. Gjithashtu, kërkon që menaxhmenti të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Kompanisë. Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë gjykimi ose kompleksiteti, ose fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë të shpalosura në Shënimin 5.

Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura, përveçse kur thuhet ndryshe (shih Shënimin 6 & 7 për standardet e reja dhe të ndryshuara të miratuara nga Kompania).

3. Përkthimi i valutave të huaja

Monedha funksionale e Kompanisë është monedha e mjedisit primar ekonomik në të cilin operon entiteti. Monedha funksionale e Kompanisë dhe monedha e prezantimit është Euro ("EUR"), e cila është monedha ligjore në Republikën e Kosovës.

Në përputhje me rregulloret e Bashkimit Monetar Evropian dhe udhëzimet e lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), EUR është miratuar si monedhë e vetme ligjore në territorin e Kosovës nga 1 janari 2002.

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Prona, impiantet dhe pajisjet

(i) Njohja dhe matja

Zërat e pasurive joqarkulluese paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e pasurisë. Kur pjesë të një elementi të pasurive joqarkulluese të kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të vecanta të pasurive joqarkulluese.

Artikujt e Pronës, Impianteve dhe Pajisjeve deri me 01 Janar 2008 prezantohen në pasqyrat financiare sipas koston së vlerësuar minus çdo amortizim dhe humbje të akumuluar nga zhvlerësimi, përderisa artikujt e Pronës, Impianteve dhe Pajisjeve pas 01 Janarit 2008 vlerësohen sipas modelit të rivlerësimit që është vlera e drejtë e zërave në datën e rivlerësimit minus ndonjë amortizim të mëpasshëm të akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostoja e vlerësuar paraqet vlerat fillestare të aseteve të vlerësuara nga Ndërmarrja me ndihmën e një konsulenti të pavarur më 31 Dhjetor 2007.

Kostot pasuese janë të përfshira në vlerën bartëse të aseteve apo njihen si një aset i veçantë, sipas nevojës, vetëm kur besohet që përfitime ekonomike në të ardhmen që lidhen me asetin do të rrjedhin për Ndërmarrjen dhe kostoja e asetit mund të matet me besueshmëri.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një elementi të pasurive joqarkulluese njihet me vlerën bartur të elementit nëse është e mundshme që përfitimet ekonomike të ardhme që i atribuohen atij elementi do t'i perkasin Kompanisë, dhe nëse kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

Humbja nga dëmtimi i aseteve: Në fund të çdo date të raportimit, menaxhmenti vlerëson nëse ka ndonjë tregues për dëmtim të pronës, impianteve dhe pajisjeve. Nëse ndonjë tregues i tillë ekziston, menaxhmenti vlerëson shumën e rikuperueshme, e cila përcaktohet si vlera më e lartë e një aseti me vlerën e drejtë minus kostot për shitje dhe vlerën e saj në përdorim. Vlera kontabël zvogëlohet në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi (dëmtimi) njihet në fitim ose humbje për vitin. Një humbje nga zhvlerësimi (dëmtimi) e njohur për një aset në vitet paraprake rikthehet kur është e përshtatshme nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e asetit në përdorim ose vlerën e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit.

Zhvlerësimi: Toka nuk zhvlerësohet. Zhvlerësimi i zërave të tjerë të pronës, impianteve dhe pajisjeve është llogaritur duke përdorur metodën lineare për të alokuar koston e tyre për vlerat e tyre të mbetura gjatë jetëgjatësisë së tyre të vlerësuar:

Jetë të dobishme në vite

Ndërtesat	20 vite
Mobilje dhe pajisje zyre	5 vite
Automjete	5 vite
Pasuri tjera të trupëzuara	5 vite

Vlera e mbetur e një aseti është vlera e parashikuar që Kompania aktualisht do të përfitojë nga nxjerrja jashtë përdorimit të asetit minus kostot e vlerësuara të nxjerrjes jashtë përdorimit, nëse aset i ishte tashmë në moshë dhe në gjendje që pritët të jetë në fund të jetës së saj të dobishme. Vlerat e mbetura të aseteve dhe jetët e dobishme rishikohen, dhe korrigjohen nëse është e përshtatshme, në fund të çdo periudhe raportuese.

Fitimet dhe humbjet nga shitja janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën kontabël neto dhe njihen neto brenda të ardhurave/shpenzimeve tjera operative në fitim ose humbje.

Instrumentet financiare

Njohja dhe çregjistrimi

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare njihen kur kompania bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit financiar. Pasuritë financiare çregjistrohen kur të drejtat e kontratës për rrjedhat e parave nga pasuria financiare skadojnë, ose kur pasuria financiare dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet transferohen. Një detyrim financiar çregjistrohet kur shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon.

Klasifikimi dhe matja fillestare e aktiveve financiare

Me përjashtim të atyre të arkëtueshmeve tregtare që nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi dhe që maten me çmimin e transaksionit në përputhje me SNRF 15, të gjitha pasuritë financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të korigjuar për kostot e transaksionit (kur është e aplikueshme).

Pasuritë financiare, përveç atyre të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- kosto e amortizuar
- vlera e drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL)
- vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI).

Në periudhat e paraqitura, kompania nuk ka asnjë pasuri financiare të kategorizuar si FVOCI.

Klasifikimi përcaktohet nga të dy:

- modeli i biznesit të entitetit për menaxhimin e pasurisë financiare
- karakteristikat kontraktuale të rrjedhës së parave të pasurisë financiare.

Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet në lidhje me pasurinë financiare që njihen në fitim ose humbje paraqiten brenda kostove të financimit, të ardhurave nga financimi ose zërave të tjerë financiarë, përveç dëmtimit të llogarive të arkëtueshme tregtare, i cili paraqitet brenda shpenzimeve të tjera.

Matja pasuese e pasurive financiare

Pasuritë financiare me kosto të amortizuar

Pasuritë financiare maten me koston e amortizuar nëse pasuritë plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk përcaktohen si FVTPL):

- ato mbahen brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është të mbajë pasuritë financiare dhe të mbledhë rrjedhat kontraktuale të parasë
- kushtet kontraktuale të pasurive financiare shkaktojnë rrjedha të parasë që janë vetëm pagesa të principalit dhe kamatës mbi shumën kryesore të mbetur

Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Skontimi shmanget kur efekti i skontimit është jomaterial. Paraja dhe ekuivalentët e parave të kompanisë, llogaritë e arkëtueshme dhe shumica e të arkëtueshmeve tjera hyjnë në këtë kategori instrumentesh financiare, si dhe obligacione të listuara që më parë ishin klasifikuar si të mbajtura deri në maturim nën SNK 39.

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL)

Pasuritë financiare që mbahen brenda një modeli biznesi të ndryshëm përveç "mbajtjes për të mbledhur" ose "mbajtjes për të mbledhur dhe shitur", kategorizohen në vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes. Për më tepër, pavarësisht nga pasuritë financiare të modelit të biznesit, rrjedhat e parasë kontraktuale të të cilave nuk janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit llogariten në FVTPL. Të gjitha instrumentet financiare derivative hyjnë në këtë kategori, përveç atyre të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtës, për të cilat aplikohen kërkesat e kontabilitetit mbrojtës.

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI)

Kompania trajton pasuritë financiare në FVOCI nëse pasuritë plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- ato mbahen nën një model biznesi, objektivi i të cilit është "mbajë për të mbledhur" dhe shes rrjedhat përkatëse të parave
- Kushtet kontraktuale të pasurive financiare shkaktojnë rrjedha të parave që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të mbetur.

Çfardo fitimi ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) do të riciklohet pas çregjistrimit të aktivit.

Dëmtimi i pasurive financiare

Kërkesat e SNRF 9 për zhvlerësimin të përdorin më shumë informacione të ardhshme për të njohur humbjet e pritura të kredisë - modeli "i humbjes së pritshme të kredisë (ECL)". Kjo zëvendësoi "modelin e humbjes së shkaktuar" të SNK 39. Instrumentet brenda objektit të kërkesave të reja përfshijnë kredi dhe aktive të tjera financiare të llojit të borxhit të matur me kosto të amortizuar dhe FVOCI, arkëtime tregtare, asete kontrate të njohura dhe të matura sipas SNRF 15 dhe angazhimet e kredisë dhe disa kontrata të garancisë financiare (për emetuesin) që janë nuk matet me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

Njohja e humbjeve të kredisë nuk varet më nga kompania që së pari të identifikoj një ngjarje të humbjes së kredisë. Përkundrazi, kompania merr në konsideratë një gamë më të gjerë informacioni kur vlerëson rrezikun e kredisë dhe matë humbjet e pritura të kredisë, përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetshme që ndikojnë në mbledhjen e pritshme të rrjedhave të ardhshme të parave të instrumentit.

Dëmtimi i pasurive financiare (vazhdim)

Në zbatimin e kësaj qasje që shikon përpara, bëhet një dallim midis:

- instrumentet financiarë që nuk janë përkeqësuar ndjeshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare ose që kanë rrezik të ulët kredie ('Faza 1') dhe
- instrumente financiarë që janë përkeqësuar ndjeshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kredisë i të cilit nuk është i ulët ('Faza 2').

"Faza 3" do të mbulojë pasuritë financiare që kanë dëshmi objektive të dëmtimit në datën e raportimit. "12-mujt e pritshme të humbjes së kredisë", njihen për kategorinë e parë, ndërsa "humbjet e pritshme të kredisë përgjatë jetës" njihen për kategorinë e dytë.

Matja e humbjeve të pritura të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar i mundshëm i humbjeve të kredisë gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

Të arkëtueshmet dhe pasuritë e kontraktuara

Kompania përdor një qasje të thjeshtuar në kontabilitetin e të arkëtueshmeve, si dhe pasuritë kontratës dhe regjistron lejimin e humbjes si humbje të pritshme të kredisë. Këto janë mangësitë e pritura në rrjedhat kontraktuale të parasë, duke marrë parasysh potencialin e mospagimit në çdo moment gjatë jetës së instrumentit financiar. Në llogaritjen, kompania përdor përvojën e tij historike, treguesit e jashtëm dhe informacionin e ardhshëm për të llogaritur humbjet e pritura të kredisë duke përdorur një matricë provizionit.

Kompania vlerëson dëmtimin e të arkëtueshmeve tregtare në bazë kolektive pasi ato posedojnë karakteristika të rrezikut të përbashkët të kredisë për të cilët ata janë grupuar bazuar në ditët e kaluara.

Klasifikimi dhe matja e detyrimeve financiare

